



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion

**ZJ.** \_\_\_\_\_

E nderuar,

Në vijim të shkresës suaj administruar pranë nesh me Nr.8160 Prot, datë 27.05.2021 ju bëjmë me dije se:

Bashkia e Shkodrës në vitin 2016, me krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, me vizionin “Shërbime sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”, njëkohësisht ka filluar punën për ngritjen e shërbimit social në komunitet; një shërbim i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm jo vetëm për shtrirjen gjeografike të territorit të Bashkisë së Shkodrës pas reformës territoriale, por edhe me synimin e ofrimit të shërbimit social sa më pranë komunitetit. Kështu, filloi krijimi i rrjetit të shërbimeve sociale në komunitet me Qendrat Komunitare “Për familjen”, të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Aktualisht janë të ngritura dhe funksionale 12 të tilla, të shtrira në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Këto qendra ofrojnë shërbime parashoqërore si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj., ofrojnë shërbime komunitare si mbrojtja e fëmijëve, fuqizim ekonomik për familjen, programe për prindërimin pozitiv, klasa pas shkollore, shërbime për kujdesin shëndetësor, etj. Të gjitha shërbimet e lartpërmendura ofrohen për kategoritë vulnerable: fëmijë, të rinj, persona me aftësi të kufiuar, rom dhe egjiptian, viktimat e dhunës, të moshuar, etj.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar) me Ligjin Nr.47/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për Masa ndaj Dhunës në

Marrëdhëniet Familjare”; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”, në Bashkinë e Shkodrës janë të ngritur dhe funksional:

**1.Komiteti drejtues**, i drejtuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër dhe i përbërë nga drejtuesit e institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel vendor.

**2.Ekipi teknik ndërdisiplinor** i përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve pjesë të komitetit drejtues.

**3.Koordinatori vendor** për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

ETN mblidhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja.

Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblidhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në vazhdim kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë.

**Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve** në Bashkinë e Shkodrës është njësi e posaçme brenda strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe ka për detyrë në mënyrë të posaçme parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

Pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve punon një staf i kualifikuar me formim punonjës social, të cilët ofrojnë shërbime për parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, shërbime që ofrohen pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” në Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka krijuar dhe ka funksional grupin teknik ndërsektorial, i cili ka për qëllim trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Pjesë përbërëse e këtij grupi janë përfaqësues të strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve si: policia, strukturat e shërbimeve sociale, arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës dhe kontribuon për marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

Që nga viti 2015, Bashkia Shkodër ka të krijuar dhe funksionale strehëzën e emergjencës për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë këtu dhe dhunën seksuale. Strehëza menaxhohet në bashkëpunim me organizatën “Gruaja tek Gruaja”. Tashmë në funksion të trajtimit dhe menaxhimit të çdo rasti të dhunës ekziston edhe shërbimi “On Call”, i cili mundëson menaxhimin 24 në 24, 7 në 7, si për të miturit, ashtu dhe personat mbi 18 vjeç.

Në lidhje me strehimin, Bashkia Shkodër ka zbatuar disa programe te strehimit social dhe ka zbatuar disa projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit të komuniteteve në nevojë siç janë:

-Banesat Sociale me Qira pranë Qendrës Komunitare “Për familjen” nr. 6, që kanë si qëllim të ofrojnë strehim të përshtatshëm për jetimët e dalë nga institucionet rezidenciale si dhe familje një prindërore në kushte të vështira sociale ekonomike.

-Subvencioni i interesave të kredisë si një instrument financiar për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, me anë të të cilit familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese.

- Granti i menjëhershëm është një tjetër instrument financiar për lehtësimin e zbatimit të BKU, me anë të cilit familjet që kanë përfituar banesa me kosto të ulët dhe që i përkasin disa kategorive të përcaktuar në ligj kanë të drejtë të përfitojnë një grant të menjeheshëm për të lehtësuar pagesën.

- Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

- Banesat sociale për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom, ku do të përfitojnë familje të komunitetit rom të cilët do të mbështeten për fuqizimin dhe integrimin e tyre social.

-Banesat sociale me qira që po ndërtohen pas përshtatjes për strehim të konviktit të shkollës veterinare, ku do të përfitojnë 28 familje në nevojë për strehim.

Të gjitha viktimat e dhunës kanë prioritet në kriteret e programeve të strehimit.

Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

## **KONTAKT:**

[www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

[shërbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al](mailto:shërbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al)

fb: Drejtoria e Shërbimeve Sociale. Strehimit dhe Shëndetit Publik-Shkodër

[www.shkodrarinore.gov.al](http://www.shkodrarinore.gov.al)

fb: Qendra Rinore Atelie

Duke ju falenderuar,

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**